

VENDIM
Nr. 170, datë 4.11.2020

**MBI KËRKESËN E FSHU SHA, PËR DISA NDRYSHIME NË “KONTRATËN TIP
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU SHA, PËR FURNIZIMIN E
KLIENTËVE FUNDORË”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/6 prot., datë 30.10.2020, të përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me disa ndryshime në “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë,

konstatoi se:

- ERE ngarkohet me detyrën për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë.

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 73, datë 22.4.2020, vendosi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal për furnizimin e klientëve fundorë.

- Në datën 7.5.2020, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 3882 prot., ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 8.6.2020, vendosi: Zgjatjen me 30 ditë të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 675/5 prot., datë 18.6.2020, iu drejtua shoqërisë FSHU sh.a. me kërkesën për informacion më të zgjeruar, në lidhje me shkaqet ligjore që e çuan në një kërkesë të tillë për rishikimin e dispozitave të kontratës së miratuar, si dhe kërkesën për një analizë të argumentuar në lidhje me impaktin financiar, që sipas FSHU sh.a. mund të shkaktojnë dispozitat e kontratës, e cila është miratuar nga ERE pas një procesi të gjatë konsultimi me palët në kontratë si dhe palët e interesit.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj protokolluar në ERE me nr. 675/6 prot., datë 6.7.2020, iu drejtua ERE-s me shpjegime në lidhje me sa kërkohej, si dhe kërkesën për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s, në lidhje me kërkesën për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020.

- Në vijim të kërkesës së mësipërme, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 17.7.2020, vendosi:

Pranimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë”, deri në përfundimin e negociatave mes palëve në kontratë, për ndryshimet në nenin 9 të kësaj kontrate.

- Së fundmi, me shkresën nr. 1115 prot., datë 24.9.2020, shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., së bashku i janë drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për periudhën kohore 1 janar–31 dhjetor, për vitet 2020 dhe 2021.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a. ka sjellë, gjithashtu, në ERE një shkresë sqaruese në lidhje me këtë propozim, me nr. 5204/2 prot., datë 7.10.2020, duke bërë me dije, se:

- Palët në këtë kontratë pas negociatave kanë dakordësuar kontratën e përcjellë për miratim me shkresën nr. 1115 prot., datë 24.9.2020.

- FSHU-ja tërhiqet nga kërkesa për rishikimin e vetëm të nenit 9 të kontratës tip, për të cilën ERE ka filluar procedurën me vendimin nr. 8/2020, duke shtuar edhe dispozita të tjera për të cilat kërkon nga ERE rishikimin.

- Kodi i Procedurave Administrative parashikon të drejtën e palëve që të kërkojnë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë, që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihenin dhe mund të dihenin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.

- Zgjatja e afatit procedural, me kërkesë të palës së interesuar, lidhet ekskluzivisht me zgjatjen e këtij afati, me qëllim që brenda këtij objekti kërkesë pala kërkuese të japë shpjegimet e nevojshme që mund të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi të ndryshëm, si dhe dakordësisë me shoqërinë KESH sh.a.

- Sa më sipër, zgjatja e afatit procedural për shqyrtimin e kërkesës nuk legjitimon palën kërkuese për ndryshim edhe të objektit të kërkesës duke e zgjeruar atë.

- Vlen për të sjellë në vëmendje që edhe ndryshimet në objektin e kërkesës duke e zgjeruar atë me propozimin për ndryshimin e disa pikave të kontratës, vijnë të paargumentuara, ndërkohë që të dyja palët kanë operuar mbështetur në kushtet e parashikuara të kontratës tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73/2020.

- Duke marrë në konsideratë mungesën e provave apo shpjegimeve për të legjitimuar rishikimin e kontratës tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73/2020, duke i dhënë asaj fuqi prapavepruese në muajt e fundit të vitit kalendarik, vlerësojmë se për vitin 2020, marrëdhënia ndërmjet palëve KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të trajtohet sipas përcaktimeve të kontratës së miratuar me vendimin nr. 73, datë 22.4.2020, të Bordit të ERE-s.

- Duke qenë se propozimi i ardhur nga palët me shkresën nr. 1115 prot., datë 24.9.2020, ka ardhur para fillimit të vitit 2021 dhe palët janë të njohura me kushtet e vendosura në kontratë (*ex ante*) dhe, për rrjedhojë, kanë gjithë kohën e nevojshme për të realizuar planifikimet/skedulimet përkatëse, duke pasur në konsideratë parashtrimet e kontratës së dakordësuar, vlerësojmë se palët kanë të drejtë të propozojnë ndryshime në kontratën tip, me qëllim rregullimin në të ardhmen të marrëdhënies kontraktuale e tregtare mes tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, BORDI i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”, për ndryshimin e propozuar nenit 9 të kësaj kontrate, si të paarsyetuar dhe të pambështetur në prova.

2. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FSHU sh.a. dhe KESH sh.a., rishikim të vendimit të ER-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë për ndryshimet si më poshtë:

Neni 1 ndryshon: shtohet shprehja “... së bashku me shtojcat apo anekset e saj ...”.

Neni 2 ndryshon: është hequr shprehja “ose kompensojë financiarisht”.

Në pikën 3 ndryshon shprehja në “... me çmimin e HUPLEX për atë moment ...”.

Në pikën 4 ndryshon shprehja në “... brenda afatit të vendosur nga shitësi ...”.

Neni 3 ndryshon titullin “Përkufizimet”.

1. Përkufizimet: Termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në shtojcën 1.

2. Interpretimi: Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.

5. “Dita e punës” do të thotë një ditë përveç të shtunës dhe të dielës), në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila palë ka zyrën e saj të regjistruar;

6. “Përgjegjësia për balancimin”, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

7. “Koha qendrore evropiane” ose “CET” do të thotë koha qendrore evropiane dhe do të përfshijë kohën dimërore qendrore evropiane dhe kohën verore qendrore evropiane, sipas zbatimit.

8. “Konfirmimi” ka kuptimin e specifikuar në nenet 5 dhe 6.

9. “Kapaciteti i kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë kapaciteti i vendosur mes palëve, i shprehur në mw; 3 FSHU ICSH.

10. “Çmimi i kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë çmimi i vendosur nga asambleja e shitësit, sipas VKM-së nr. 244/2016 të ndryshuar.

11. “Sasia e kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë sasia e vendosur mes palëve, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, e shprehur në mwh.

12. “Dëmet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13 (Kufizimi i përgjegjësisë financiare).

13. “Pala që nuk përmbush detyrimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10 (Pezullimi i livrimit).

14. “Filial”, lidhur me një palë, do të thotë një njësi e kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo palë, çdo njësi që kontrollon direkt ose indirekt atë palë ose çdo njësi direkt ose indirekt nën kontrollin e përbashkët të një pale.

15. “Pika e livrimit”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë pika e livrimit e vendosur mes palëve.

16. “Programi i livrimit”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë programi i livrimit i vendosur mes palëve për ditën në avancë sipas rregullave përkatëse;

17. “Data e pagesës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.2 (pagesa)

18. “Data e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj kontrate;

19. “Programi” ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3 dhe 7.2 (Përkufizimi i programit) dhe “1 programuar” dhe “programimi” do të interpretohen sipas kësaj.

20. “Taksë” do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjokat dhe shtesat e tyre) që vendoset

nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij), lidhur me çdo pagesë, sipas kontratës, përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë takse të ngjashme.

21. “Pamundësia e prodhimit, si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi” përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji (shtojca 3), nën të cilin shitësi, me kërkesën e blerësit është i detyruar të prodhojë, duke mos qenë subjekt i kompensimit financiar, sipas pikës 1, të nenit 9, të kësaj kontrate.

22. Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij), lidhur me çdo pagesë, sipas kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë takse të ngjashme.

Neni 5 ndryshon në “... nominimi i pranuar nga platforma e OST për nominimet.”.

Është shtuar pika e pestë me përmbajtje “5. Shitësi ka detyrimin që në fund të çdo muaji të njoftojë blerësin, në lidhje me nivelin në liqenin e Fierzës, me qëllim evidentimin e faktit nëse ndodhet në kushtet e pamundësisë së prodhimit, si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi sipas përcaktimeve të kësaj kontrate).”.

Neni 6, në pikën 2, ndryshon në “... e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës”.

Neni 7, në pikën 3, ndryshon në “... referuar nominimit në platformën e OST për nominimet”.

Neni 9, në pikën 3, ndryshon në “... e dërguara nga blerësi ...”.

Në pikën 4 ndryshohet në “... paguhen sipas nenit 13”.

Neni 11 ndryshon në “1. Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 janar–31 dhjetor të vitit 2020 dhe 2021).

Neni 12. Neni 12 titullohet “Kufizimi i përgjegjësisë financiare që i përgjigjet nenit 13 të kontratës tip” dhe për këtë nen nuk ka ndryshime.

Neni 14 ndryshon titullin “Taksat dhe tatimet” dhe përmbajtja “çdo çështje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet në përputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15 ndryshon dhe bëhet “Transferimi”.

- Në nenin 15 të kontratës se ndryshuar, me temë “Transferimi”, në pikën 2 të saj me titull “Transferimi dhe filialet kontrata tip” shtohet në fund “me kusht që çdo dokument mbështetës kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e filialit në përfitim të palës tjetër.

3. Fillimi i procedurës për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 73/2020, nuk pezullon fuqinë juridike të këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për pikën 2 të këtij vendimi mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike dhe për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti